



Pranuar / Dorëzuar Priljeva/Prilista Received/Delivered	21.06	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKD/SHCK	3249/2021		1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.395/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.395/2021 të datës 07.05.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë: Rruga “Rexhep Krasniqi”-banesa C-6, kati III/nr.13, Kalabri, Komuna Prishtinë, kundër organit punëdhënës Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.395/2021 e datës 07.05.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas akt emërimit të datës 01.04.2014 me numër protokolli:246 e cila mbanë pozitën “Zyrtare e Lartë për Pensione të Jashtme”, më datë 07.05.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 2270/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për ngritjen e koeficientit të pagës, ekuivalente pozitën që e ushtron “Udhëheqës i Divizionit për Pensione të Jashtme”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.05.2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje ne ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Me datë 11.06.2021 Këshilli nëpërmjet e-maili ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e cila është protokolluar me datë 14.06.2021 dhe numër: 3036/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 2270/2021 të datës 07.05.2011 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për harmonizimin e koeficienteve me pozitën e punës e datës 26.01.2021; Kërkesa për harmonizimin e koeficienteve me pozitën e punës e datës 05.09.2019; E-mailin e datës 07.11.2018 dërguar nga për

ankuese; Shkresën e datës 14.05.2021 me provat shtesë; Akt emërimin e ankueses të datës 01.04.2014; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2020 i datës 31.12.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 17.05.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 14.06.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i lartë i pensioneve të jashtme”; E-mailin e datës 11.06.2021 dërguar nga _____ për Sekretarin e Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2014 me numër protokolli:246, Kolegji ka konstatuar se ankuesja mban pozitën “Zyrtare e Lartë për Pensione të Jashtme” në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, po ashtu në bazë të emailit të datës 11.07.2018 ankuesja nga Drejtori i Departamentit të Pensioneve është autorizuar deri në një vendim të mëtutjeshëm të ushtrorë detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Divizionit të Pensioneve të Jashtme, ndërsa ankuesja me datë 05.09.2021 dhe po ashtu me datë 26.01.2021 ka parashtruar kërkesën e përsëritur te Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për ngritjen e koeficientit të pagës sipas pozitës që ushtron atë të “Udhëheqëses së Divizionit të Pensioneve të Jashtme”.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se : *1.E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil* si dhe nenin 9 paragrafi 1 ku është përcaktuar se *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës”* dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se drejta në pagë është e drejtë themelore e nëpunësit civil nga marrëdhënia e punës dhe se nëpunësi civil ka të drejtën e realizimit të pagës bazë të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në provat e lëndës Kolegji konstaton se ankuesja në Akt Emërimin e saj të datës 01.04.2016 ka të përcaktuar ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës dhe së e njëjta realizon po koeficientin tetë (8) të pagës.

Ndërsa, përkitazi me pretendimin ankimor për ngritje të koeficientit-gradës së pagës, Kolegji i është referuar nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, më të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *“1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa”*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se çdo ngritje e koeficientit-gradës realizohet në respektim të plotë të këtyre dispozitave ligjore nga ana e organit të punësimin, e si rrjedhojë pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar, ndërsa ankuesja me rastin e parashtrimin të ankesës në Këshill dhe provave të bashkangjitura dhe po ashtu asnjësi e personelit në përgjigjen në kërkesë të datës 11.06.2021 nuk ka sjellë asnjë provë relevante me të cilën dëshkohet se ka pasur ndonjë vendim apo zhvillim të procedurave për avancim në karrierë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil që ka të bëjë me ngritjen në detyrë apo avancim në karrierë të ankueses siç pretendon në ankesë, mirëpo Kolegji vlerëson se detyrat me të cilat është ngarkuar ankuesja përmes e-mailit të datës 07.11.2018 nga Drejtori i Departamentit të Pensioneve hyjnë në kuadër të përgjegjësisë që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 29 i cili përcakton se: *“Nëpunësve civilë mund t’u kërkohej që përkohësisht të kryejnë detyra, që janë jashtë funksioneve të tyre normale, nëse kjo është e domosdoshme për shkak të interesit të përgjithshëm”*, ndërsa



ankuesja ndaj përgjegjësive shtesë me të cilat është ngarkuar nuk ka parashtruar ndonjëherë ankesë apo kundërshtim tek udhëheqësi i drejtpërdrejtë apo Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.395/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

